



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>2-D/DPK</u>	Nr Prot Br Prot <u>01-2490/14</u>
Nr. I faq. Broj stranica <u>02</u>	Data Datum <u>03.07.2014</u>
Nr. pages	Date



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 30.06.2014, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-1775/14, për z. Basri Denjani – Anëtar i Kuvendit Komunal – Hani i Elezit, për arsye se i njëjti ka shmangur situatën e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik, nr. AKK – 03-1775/14, për zyrtarin e lartë z. Basri Denjani – Anëtar i Kuvendit Komunal – Hani i Elezit, dhe njëkohësisht pronar i vetëm në biznesin privat D.P.T. “VW”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Në këtë rast, zyrtari i lartë z. Denjani, së pari është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit lidhur me funksionin e tij publik.

Pas pranimit të kësaj shkrese, zyrtari në fjalë, është kontaktuar nga zyrtarët e Agjencisë dhe i është sqaruar situata në të cilën ndodhet. Ai është bindur me fakte për situatën në të cilën ndodhet dhe me ndryshimet që duhet t'i bëj për të shmangur situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

z. Denjani ka pranuar rekomandimin e Agjencisë që të autorizoj një person të besueshëm për të udhëhequr këtë biznes në mënyrë që të shmanget situata e mundshme e konfliktit të interesit.

Ndërkohë, i njëjti ka dërguar në Agjenci shkresën zyrtare nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI 03 - 2373/14) me të cilat vërtetohet se ai ka autorizuar një person të besueshëm për të udhëhequr biznesin privat D.P.T. "VW".

Prandaj, duke pasur parasysh këto të dhëna, konstatohet se gjendja e mundshme e konfliktit të interesit është shmangur.

Andaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

